



Shpallja e Akademisë Virtuale të Filadelfias
Dita e Informacionit • E Mërkurë, 8 Maj 2013 • 6:00-7:30PM
në “Qendrën Mësimore të Filadelfias”
440 N. Broad Street, Philadelphia, PA • Room 1075 (First Floor)

prill 26, 2013

I Dashur Prind/Kujdestar,

Me anë të kësaj letre dëshiroj të ndaj me ju disa lajme mjaft të gëzuara, për vitin e ardhshëm shkollor. Drejtoria Arsimore e Filadelfias me krenari ju njofton për shtrirjen e programit të saj mësimor, duke përfshirë opsionin online me kohë të plotë për nxënësit e klasave 6-12, të cilët kërkojnë një orar shkollor më fleksibël, por të cilët kërkojnë akses në shumë prej shërbimeve që ofron Drejtoria Arsimore e Filadelfias.

Si një familje fëmijët e të cilës aktualisht vazhdojnë shkollën çarter, ne e mirëpresim mendimin tuaj për t'u rikthyer në Drejtorinë Arsimore të Filadelfias, përmes pjesëmarrjes në Akademinë Virtuale të Filadelfias (PVA).

Akademia Virtuale e Filadelfias është një shkollë falas për nxënësit të cilët kanë kaluar me sukses klasën e 5^{të}, dhe janë në kërkim të një kualifikimi cilësor online për klasat 6-12. Nxënësit do të pajisen me një kompjuter laptop, Internet me shpejtësi të lartë dhe një program mësimor të miratuar nga Departamenti i Arsimit të Pensilvanisë, i cili do të drejtohet nga mësues të çertifikuar dhe me nivel të lartë. Në vazhdim, nxënësit do të kenë akses që të vijnë në qendrat mësimore për mbështetje akademike, si edhe mundësinë e pjesëmarrjes në aktivitetet jashtë shkollore dhe sportive, që organizon Drejtoria Arsimore.

Nxënësit që do të plotësojnë kërkesat përmes PVA, do të pajisen me diplomë të Shkollës së Mesme, nga Drejtoria Arsimore e Filadelfias.

Në Drejtorinë Arsimore të Filadelfias ne e kemi të qartë se fëmijët kanë mënyra të ndryshme të të mësuarit. Disa nxënës dallohen në mënyrën tradicionale të vajtjes në shkollë, ndërsa të tjerë janë më të suksesshëm në studimin individual. Duke punuar së bashku si një grup, Unë jam i bindur, se ne mund t'i sigurojmë çdo fëmijë përvojën që jep më tepër rezultat për të, në shkollën publike tradicionale, ose në shkollën e re të Drejtorisë- Akademinë Virtuale të Filadelfias.

Unë ju ftoj që të mësoni më tepër për PVA, në ditën informative për prindërit dhe nxënësit, që do të mbahet **ditën e Mërkurë datë 8 Maj 2013** nga ora **6:00PM deri 7:30PM** në Qendrën tonë Mësimore me adresë, 440 N. Broad Street, Philadelphia, PA. Presim me kënaqësi të takohemi me ju në dhomën 1075 (Kati i Parë).

Unë kam bashkëngjitur një broshurë, që sqaron më mirë akademinë tonë të re dhe klasat që ofron ajo. Nëse keni pyetje, ose dëshironi më tepër informacion, ju lutemi telefononi PVA në numrin 215-400-8480, ose vizitoni www.philasd.org/language/albanian/help.

Sinqerisht,

William R. Hite, Jr., Ed.D.
Superintendent i Shkollave
Drejtoria Arsimore e Filadelfias

Ejeni në “Open House”, këtë Pranverë!

PERSONALISHT:

E Mërkurë 8 Maj 6:00-7:30 PM
Education Center (440 N. Broad Street, Rm. 1075)

E Mërkurë 15 Maj 5:30-7:00 PM
Kensington CAPA High School (1901 N. Front St.)

E Mërkurë 29 Maj 2:00-3:30 PM
West Philadelphia High School (4901 Chestnut St.)

E Martë 11 Qershor 5:30-7:00 PM
Northeast High School (1601 Cottman Ave.)

ONLINE:

E Enjte 2 Maj 1:00-2:00 PM
E Enjt. 6 Qershor 11:00 AM-12:00 PM
E Mërkurë 10 Korrik 7:00-8:00 PM
E Enjte 8 Gusht 1:00-2:00 PM

Sesionet Online zhvillohen në dhoma takimesh virtuale; vizitoni uebsajtin e Akademisë Virtuale <http://www.philasd.org/pva> për instruksione.